



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Fëmijëve



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201701634/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2017

**Lënda :** *Rekomandime lidhur me inspektimin e realizuar pranë Institutit të Nxënësve që nuk shikojnë "Ramazan Kabashi", Tiranë.*

**Drejtuar:** **Z. Koli Bele**  
**Sekretar i Përgjithshëm**  
**Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë**

**Z. Xhemal Xhafa**  
**Drejtor i Shkollës**

**Znj. Arjola Byzyka**  
**Drejtor i Drejtorisë Arsimore**

**Z. Arian Kraja**  
**Sekretar i Përgjithshëm**  
**Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**

**Tiranë**

Seksioni i Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, duke u nisur nga deklarimi në media në emisioni BOOM në televisionin "Ora news", si dhe duke vlerësuar ankshën e Drejtorit të Institutit të Nxënësve që nuk shikojnë "Ramazan Kabashi", në datën 11.12. 2017, kreu një inspektim në këtë institutë. Avokati i Popullit pasi shqyrtojë informacionin nga monitorimi i realizuar ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrijë konkluzionet përfundimtare.

**Objektivat e inspektimit:**

- Vlersimi i kushteve, mjediseve ku ofrohen shërbimet për fëmijët që nuk shikojnë.
- Respektimi i të drejtave të të fëmijëve në zbatim të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

**Metodologjia**

Grupi inspektues i institucionit të Avokatit të Popullit, i përbërë nga një juriste dhe një punonjës social, si metodologji pune ka përdorur:

- Zhvillimin e bisedave paraprake me drejtuesit e këtij institucioni, informacion i cili është hedhur në një formular standard për inspektimet e këtyre institucioneve.

- Kontrollin i dokumentacioneve përkatëse të cilat lidhen me problematikat e shfaqura në media.
- Inspektimin në vend të kushteve materiale në të cilat jetonin fëmijët, ambientet e përbashkëta, dhomat e gjumit, tualetet, dushet, pajisjet e hotelerisë, veshmbathjet, ushqimin, kuzhinën, lavanterinë, higjienën, lagështirën, bombolat kundër zjarrit, ambientet e jashtme të këtyre institucioneve etj.

Në përfundim të inspektimit, grupi monitorues i Institucionit të Avokatit të Popullit ka kryer bisedën përmbyllëse me drejtuesin e institucionit dhe stafin në shërbim të drejtëpërdrejtë me përfituesit, ku u adresuan problematikat e evidentuara gjatë inspektimit ku u lanë edhe rekomandimet përkatëse, të cilat gjenden të detajuar në fund të raportit.

### **Funksionimi dhe Administrimi i institutit të nxënësve që nuk shikojnë**

Instituti i nxënësve që nuk shikojnë “Ramazan Kabashi”, Tiranë është institucion edukimi për fëmijët që kanë problem me shikimin të grupmoshës 5-17 vjeç. Ky institucion ka varësi administrative të dyfishtë nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Bashkia Tiranë. Organograma e këtij institucioni përbëhet nga 45 punonjës ku 29 punonjës të cilët janë staf pedagogjik të cilët paguhet nga fondet e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe 16 punonjës të cilët paguhet nga fondet e Bashkisë Tiranë. Në këtë institucion edukohen 66 fëmijë ku 50 fëmijë janë nga bashki të ndryshme të vendit dhe 16 fëmijë janë nga Bashkia Tiranë. Institucioni ka rregulloren e brendshme e cila nuk është në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi të sistemit parauniversitar.

Nga vlersimi i dokumentacioneve për organizimin dhe funksionimin e këtij institucioni rezultoi se institucioni ka rregulloren e brendshme të funksionimit dhe organizimit e cila është e miratuar nga Bordi i Shkollës. Ky proces miratimi nuk është në zbatim të pikës 12, të nenit 38, të “Dispozitave Normative, Për Sistemin Arsimor Parauniversitar” ku thuhet se “*Rregullorja e brendshme e institucionit arsimor: a) hartohet, nën drejtimin e drejtorit të institucionit arsimor, nga grupe të gjera pune që përbëhen nga mësues, nxënës, prindër dhe përfaqësues të tjerë nga komuniteti; b) paraqitet për shqyrtim nga drejtori i institucionit arsimor te bordi i institucionit; c) paraqitet për miratim nga drejtori i institucionit arsimor tek titullari i njësisë arsimore vendore përkatëse.*”. Rregullorja e funksionimit dhe organizimit të këtij institucioni arsimor duhet të dërgohet për miratim tek titullari i njësisë arsimore vendore përkatëse.

Për sa më sipër dhe në zbatim të Kushtetutës së RSH, ku përcaktohet që qeveria lokale krijohet në bazë të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore – *Neni 13 i Kushtetutës*, si dhe në zbatim të pikës 9 të nenit 6 të ligjit 69/2012 “**Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë**” ku thuhet se “*Sistemi arsimor parauniversitar funksionon mbi bazën e decentralizimit dhe autonomisë së ligji parauniversitar*” në kuptim të këtij përcaktimi, konkludojmë se baza ligjore është pjesërisht e kompletuar dhe sa më shpejt të jetë e mundur të hartohen aktet nënligjore të cilat duhet të adresojnë kompetencat e gjithsecilit nga aktorët dhe masat konkrete për të siguruar zbatimin e ligjit dhe shkeljet ose moszbatimin e tij.

Nisur nga problematika e cila është shfaqur në emisioni BOOM në televisionin “Ora News”, ekipi i institucionit të Avokatit të Popullit pyeti drejtuesin dhe psikologun e institucionit lidhur me masat e ndërmarra për informimin e nxënësve për këtë çështje ku na u konfirmua se nuk është ndërrmarë asnjë masë. Në këto kushte Institucioni i Avokatit

të Popullit duke vlerësuar interesin më të lartë të fëmijës në zbatim të pikës 3, të nenit 6, të ligjit Nr. 8/2017 datë 23.2.2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” ku thuhet se *“Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën”* nuk realizoi intervistat me nxënësit e shkollës. Avokati i Popullit është i shqetësuar se pjesëmarrjen e fëmijëve në vendimarrje gjatë trajtimit të problematikave/cështjeve të ndryshme të cialt ndodhin në institucionin ku ata zhvillohen, rriten dhe edukohen/arsimohen. Këtë mosveprim nga ana e stafit të institutit të nxënësve që nuk shikojnë, Avokati i Popullit e bazon në zbatim të nenit 12 të Konvetës “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” ku parashikohet e drejta për t’u dëgjuar zëri i fëmijëve dhe pjesëmarrjen e tyre në vendimarrje në të gjitha aspektet e veprimtarisë të institucionit për çdo vendim që merrret në të, fëmijët duhet të pyeten, të dëgjohen duke ja shpjeguar në një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme sipas zhvillimit të tyre duke vlerësuar mendimin e tyre si edhe duke i bërë pjesë të vendimarrjes sin ë rastin e ndodhur.

### **Kushtet materiale**

Instituti i nxënësve që nuk shikojnë “Ramazan Kabashi” përbëhet nga dy godina dy katëshe. Në godinën e parë janë ambientet e akomodimit të fëmijëve nga qytetet e tjera dhe administrate ndërsa në godinën e dytë janë ambientet ku edukohen dhe arsimohen fëmijët.

Në katin e parë të godinës së parë, janë të vendosura, zyra e financës, infermiera, mensa, kuzhina, lavaxantaria, magazina e hotelarisë së konviktit, magazina ushqimore. Kuzhina është e pajisur me dy soba industriale ku njëri i funksiononin vetëm plitkat dhe tjetri furra dhe një frigorifer në gjëndje me kapacitet normal ku mbaheshim të gjitha ushqimet të cilat dilnin nga magazine ushqimore. Gjithashtu në magazinën ushqimore janë edhe dy frigorifera njëri prej tyre bank-frigorifer jo ngrirës, të dy të konsumuar por në gjëndje pune. Ndërsa në katin e dytë janë të vendosura dhoma e televizorit/kalimit të kohës së lirë, dhomat e gjumit për djemte dhe vajzat; zyra e psikologes dhe drejtuesit. Infrastruktura dhe higjiena e godinës janë në përputhje me standardet të cilat lehtësojnë lëvizjen e fëmijëve. Dhomat e gjumit janë me parket dhe me tualet brenda si dhe të pajisuara më të gjitha artikuj hotelarik, krevate, dyshek, dollap, komodian carcafë, jastëk, batanije. Këto pajisje/artikuj hotelarik përvec carcafëve dhe jorganeve ishin të reja, ku blerëjt e fundit të këtyre artikujve janë bërë në vitin 2015 nga fondet e buxhetit të shtetit. Carcafët janë të vjetër por jo të konsumuar për të dal jashtë përdorimit të tyre. Pajisjet/artikujt hotelarik janë donacione të cilat janë siguruar nga Tika dhe Diakoma. Këta donator kanë investuar edhe në ristrukturimin e dhomave dhe tualeteve të kësaj godine ku kanë mundësuar parrisjen e tualeteve me artikuj sanitor, si dhe shtrimin e dhomave të gjumit me parket.

Nga monitorimi i ambienteve dhe analizës së lartëpërmendura theksojmë se kushtet e strehimit dhe furnizimit me artikuj të dhomave të gjumit, të gatimit, etj) ishin në parametra normale. Nga verifikimi i ambienteve grupi i inspektimit në kuadër të përmirësimit të cilësisë së jetës dhe përmbushjes së misionit të Institucionit të Avoktit të Popullit për

mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve domosdoshmërisht lind nevoja për blerjen e një frigoriferi, sobe industrial si carcafëve dhe jorganëve të rinjë për vitin 2018.

### **Analiza ligjore për ndjekjen e institucioneve arsimore nga fëmijët me aftësi të kufizuara**

Në vlerësimin e kuadrit ligjor të arsimit shqiptar i cili garanton të drejtën e plotë për arsimin publik të çdo fëmije pavarësisht nga nevojat dhe aftësitë e veçanta institucioni i Avokatit të Popullit kërkoi gjatë inspektimit informacion/të dhëna për të verifikuar nëse përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore të specializuara sic është instituti në fjalë është përgjithësisht i përkohshme. Këtë informacion e kërkuan bazuar në 6 pikat e nenit 64, të ligjit Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” ku thuhet se “*Ndjekja e institucioneve arsimore nga fëmijët me aftësi të kufizuara*”

1. *Nxënësve me aftësi të kufizuara u sigurohet arsimimi në shkollat e arsimit të mesëm e të lartë sipas kriterëve të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit dhe Ministria e Shëndetësisë.*
2. *Nxënësi me aftësi të kufizuara qëndron në shkolla të specializuara deri në moshën 19 vjeç.*
3. *Njësia arsimore vendore krijon një komision të përbërë nga mjekë, psikologë, mësues dhe specialistë për fëmijët me aftësi të kufizuara, i cili, pasi shqyrton kërkesën e prindit ose të drejtorit të një institucioni arsimor, jep rekomandimet përkatëse për ndjekjen nga fëmija të një institucioni arsimor të zakonshëm a të specializuar.*
4. *Prindërit vendosin nëse fëmija e tyre me aftësi të kufizuara do të ndjekë një institucion të specializuar ose të zakonshëm të arsimit bazë. Prindërit mund të largojnë në çdo kohë nga shkolla fëmijën, kur e gjejnë se ai nuk përfiton nga mësimet ose ka mundësi të tjera më të mira.*
5. *Ministria, në bashkëpunim me njësinë bazë të qeverisjes vendore dhe në këshillim me prindërit e komisionin, siguron arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në njërin nga dy llojet e institucioneve arsimore, të zakonshme ose të specializuara.*
6. *Njësia arsimore vendore, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të Ministrisë së Shëndetësisë, i siguron arsimim në shtëpi nxënësve që nuk mundin të ndjekin një shkollë të zakonshme ose të specializuar të arsimit bazë.”*

Nga informacioni i marrë nga Drejtuesi i Institucionit, ky institucion asnjë fëmijë nuk është integruar në shkollat publike as me kërkesë të prindërve, as me kërkesë të drejtuesit të institucionit as me rekomandim të komision të përbërë nga mjekë, psikologë, mësues dhe specialistë për fëmijët me aftësi të kufizuara, i cili, është ngritur pranë Drejtorisë Rajonale Arsimore, Tiranë pavarësisht çfarë parashikon legjislacioni i lartpërmenduar i vitit 2012. Shkaqet e mos zbatimit të direktivave ligjore vjen si rezultat i mos funksionimit në shkollat publike të klasave gjithëpërfshirëse ku praktika mësimore duhet të bazohet përmes, përshtatjeve, modifikimeve e përmirësimeve të vazhdueshme dhe përfundimit të procesit të akteve nënligjore të parashikuara në këto direktiva ligjore. Konkretisht drejtuesi i këtij institucioni na informoi se komisioni pranë Drejtorisë Rajonale Arsimore të Tiranë ka filluar të realizoi vlerësimet e nxënësve gjatë këtij viti. Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson ngritjen e komisionit të vlerësimit pranë Drejtorisë Arsimore Tiranë por kërkon angazhimin maksimal për të realizuar detyrën funksionale të parashikuar në ligj ku të përcaktohen kriteret specifike për vlerësimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në përputhje me standardet e vlerësimit të ICF - Klasifikimi Ndërkombëtar për

Aftësinë e Kufizuar” të hartuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH). Këto standard sigurojnë një vlerësim sa më të plotë të gjendjes shëndetësore dhe funksionale të fëmijës me aftësi të kufizuar I cili ndihmon në funksionimin e sistemit të referimit, që përcakton nivelin e funksionit dhe potencialet e zhvillimit të fëmijës me aftësi të kufizuara.

Të gjithë prindërit kanë paraqitur këkresat për regjistrimin e fëmijëve në këtë shkollë sepse në shkollat publike nuk garantohet mesimi në alfabetin Braj. Gjithashtu vonesa e krijimit të Komisioni Multidisiplinare pranë të gjitha institucioneve arsimore DAR/ZA-ve kanë penguar kryerjen e praktika të mësimdhënies në shkolla në klasa gjithëpërfshirëse në nivel vendore ku të garantohej edhe përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Mbi të gjitha, zbatimi i ligjit Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” do të jetë i suksesshëm dhe i dobishëm për fëmijët me aftësi të kufizuar vetëm nëse plotësohet si proces ku përfshihen edhe nxjerrjet e akteve nënligjore në zbatim të tij lidhur me integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat normale/publike. Konkretisht Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në zbatim të pikës, 1 dhe 6, të nenit 64, të ligjit Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” kanë detyrimin për të nxjerr udhëzimet përkatëse. Mosplotësimi i këtij ligji me hartimin e akteve nënligjore të cilat do të orientonin dhe udhëzonin zbatimin konkret të tij, kanë penguar fillimin e instalimit të sistemit gjithëpërfshirës të arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara”.

### **Gjetjet:**

Në vlerësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit nisur nga analiza e lartpërmendur e bazur në prova, vëzhgime dhe të dhënat e stafit dhe drejtuesit e institucionit ky i fundit konsideron përpjekjet e bëra për përmirësimin e infrastrukturës së ambienteve të institucionit, dhomave të gjumit, tualeteve, dhe paisjeve hotelerike përveç jorganëve dhe çarçafëve të cilat duhet të zvendesohen. Gjithashtu lind nevoja e parashikimit në buxhetin e vitit 2018, blerja e një frigoriferi dhe sobe industriale. Funksionimit dhe administrimit të institucionit i cili realizohej në zbatim të rregullores por e cila nuk është e miratuar nga Drejtoria Arsimore Tiranë në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Varësia e dyfishtë e këtij institucioni përcjell problematika në llogaridhënie duke mos patur kompetencat të mirëpërcaktuara për çdo aktorët për të siguruar zbatimin ose moszbatimin e legjislacionit për arsimin parauniversitar. Ngritja e komisionit të vlerësimit pranë Drejtorisë Arsimore Tiranë e cila duhet të funksionojë në përputhje me legjislacionin në fuqi ku të përcaktohen kriteret specifike për vlerësimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar në përputhje me standardet e vlerësimit të ICF - Klasifikimi Ndërkombëtar për Aftësinë e Kufizuar” të hartuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH). Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk kanë nxjerr udhëzimet përkatëse të cilat kanë nikuar në mos përfundimin me sukses të procesit të integritit të fëmijëve me aftësi të kufizuar në shkollat publike.

Më tej, Avokati i Popullit shpreh shqetësim lidhur me kapacitetin e dobët në përgjithësi lidhur me zbatimin efektiv të ligjeve që trajtojnë çështje të fëmijëve në nivelet rajonale dhe ato bashkiake ku mungon fryma e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës me strukturat e tjera të ngritura për mbrojtjen e fëmijëve Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës (NJMF) të cilat do të garantojnë të drejtat e fëmijëve në interesin më të lartë të tyre.

Në zbatim të nenit 21 të ligjit Nr.8454, datë 4.2.1999, ”Për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar “*paraqet rekomandime për vënien në vend të së*

*drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”;*

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave duke parashikur në planin buxhetor për vitin 2018 blerjen e carcafëve, jorganëve, sobës dhe frigoriferit industrial për institutin e nxënësve që nuk shikojnë Tiranë.
2. Marrjen e masave për vlerësimin dhe miratimin e rregullores së për institutin e nxënësve që nuk shikojnë Tiranë nga Drejtoria Arsimore Tiranë.
3. Marrjen e masave për hartimin e akteve ligjore në zbatim të pikës, 1 dhe 6, të nenit 64, të ligjit Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
4. Marrjen e masave për të përcaktuar kriteret e vlerësimit të aftësisë së kufizuar nga komisioni multidisiplinar të njësive vendore arsimore në përputhje me standardet e vlerësimit të ICF - Klasifikimi Ndërkombëtar për Aftësinë e Kufizuar” të hartuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH).për të garantuar përfshirjen dhe integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar pranë shkollave publike të njësive vendore ku ata jetojnë.
5. Marrjen e masave me qëllim që të garantohet pjesëmarrja e fëmijëve në vendimarrje në të gjitha procedurat, programet dhe projektet që ndërrmerren në institucion dhe që ndikojnë tek ta në institutin e nxënësve që nuk shikojnë “Ramazan Kabashi”, Tiranë duke u përfshirë dhe problematika e publikuar me mediat vizive shfaqur në emisioni BOOM në televisionin “Ora News” .
6. Marrjen e masave për të bashkëpunuar dhe bashkërenduar punën me mekanizmat e ngritur në nivel vendor (NJMF) në zbatim të Udhëzimit nr.10, datë 25.2.2015 “Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës”.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”.Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**K O M I S I O N E R I**

**Ermir KAPEDANI**

Konc: Matilda Tyli

